



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Bahri Asllani” B.I. e datës 05.12.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 30.11.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull “Ndriçimi për sinjalizues për vendkalime për siguri” me nr. të prokurimit 616-23-4210-5-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Bahri Asllani” B.I. e datës 03.11.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 30.11.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull “Ndriçimi për sinjalizues për vendkalime për siguri” me nr. të prokurimit 616-23-4210-5-1-1.
- II. **NJOFTOHET** operatori ekonomik “Bahri Asllani” B.I. se ky aktivitet i prokurimit tanimë është kthyer në **RIVLERËSIM** përmes vendimit të zyrtarit përgjegjës të prokurimit lidhur me një kërkesë për rishqyrtim të një tenderuesi tjetër lidhur me aktivitetin e prokurimit nga pika I e këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik “Bahri Asllani” B.I. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Operatori ekonomik “Bahri Asllani” B.I. (tutje “parashtruesi”) me datë 05.12.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 30.11.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull “Ndriçimi për sinjalizues për vendkalime për siguri” me nr. të prokurimit 616-23-4210-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë formuluar si në vijim: "Autoriteti Kontraktues me datën 01.12.2023 ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues përmes të cilit njofton Operatorët Ekonomik konkurrues se AK vendos të anulojë Aktivitetin e Prokurimit. Ne te njëjtën datë pranojmë Letrën Standarde për tenderuesin e eliminuar ku oferta jone është refuzuar vetëm me një pike pretendimi si me poshtë - Licenca e furnitorit të betonit, Titan Beton është e skaduar me datën 12.09.2023. Autoriteti Kontraktues gjate fazës së vlerësimit të tenderëve është dashur patjetër të kërkojë sqarime shtese konform nenit 72 të LPP dhe Pikës 10 të UPP".

Fillimisht duhet sqaruar se pretendimi ankimor i referohet kërkesës në dosjen e tenderit lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional të formuluar si në vijim:

OE duhet të ketë Baze për Prodhimin e betonit në Pronësi apo marrvëshje për furnizim me beton	Kopja e licencës e vlefshme e lëshuar nga Agjencioni për miniera dhe minerale. Në rastet kur OE ka marrvëshje për furnizim, OE duhet të dorëzojë edhe kopjen e marrvëshjes për furnizim.
---	--

Nga kërkesa e cituar si më sipër mund të konfirmohet se përmes dosjes së tenderit është përcaktuar në mënyrë specifike se operatorët ekonomik duhet të dorëzojnë kopjen e licencës së vlefshme të furnitorit të betonit. Në anën tjetër parashtruesi me rastin e dorëzimit të ofertës së tij ka bashkangjitur edhe një licencë e furnitorit të betonit "Titan Beton" e cila ka skaduar me datë 12.09.2023. Përndryshe ky fakt nuk mohohet as nga vet parashtruesi pasi që në kërkesën e tij për rishqyrtim nuk e mohon faktin se licenca me të cilën ka ofertuar nuk është e vlefshme sikurse është kërkuar me dosjen e tenderit por ka skaduar me datë 12.09.2023. Megjithatë parashtruesi pretendon se autoriteti kontraktues është dashur që të kërkojë sqarime shtesë në mënyrë që t'i ofroj mundësinë parashtruesit për të përmisuar këtë mangësi të ofertës së tij.

Së pari duhet sqaruar se kërkesa e dosjes së tenderit është e formuluar në mënyrë të saktë dhe precize. Si e tillë kjo kërkesë nuk është kontestuese as për parashtruesin pasi që parashtruesi ka pasur mundësi të kontestoj kërkesën e dosjes së tenderit për të cilën po bëhet fjalë në faza të mëhershme të aktivitetit të prokurimit mirëpo nuk e ka bërë këtë veprim. Sidoqoftë në kërkesën e dosjes së tenderit është kërkuar që të dorëzohet licenca e vlefshme e furnitorit të betonit ndërsa parashtruesi e ka dorëzuar një licencë të pavlefshme (me afat të skaduar disa muaj më parë). Rrjedhimisht oferta e parashtruesit është eliminuar si ofertë e papërgjegjshme.

Sa i përket pjesës së pretendimit të parashtruesit ku thuhet se autoriteti kontraktues është dashur patjetër të kërkojë sqarime shtesë lidhur me këtë fakt, duhet sqaruar se në këtë rast nuk janë plotësuar kushtet për të kërkuar sqarime shtesë në kuptim të nenit 72 të LPP lidhur me pikën 10 të UPP. Për më tepër duhet sqaruar se as neni 72 dhe asnjë dispozitë tjetër në fuqi për prokurimin publik, nuk e obligon autoritetin kontraktues për të "kërkuar patjetër sqarime" sikurse pretendon parashtruesi, në rastet e tilla kur parashtruesi ka dorëzuar dokumente të cilat janë në kundërshtim të plotë me dosjen e tenderit (si në rastin konkret). Pra LPP nuk e detyron autoritetin kontraktues që parashtruesit t'i ofroj mundësi për t'i përmisuar gabimet e tij me rastin e ofertimit. Përkundrazi sipas LPP vet tenderuesit e bartin përgjegjësinë e plotë për të përgatitur dokumentet me të cilat ofertojnë në një aktivitet të prokurimit. Përmes nenit 72 të LPP

përcaktohet se “Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura...”. Pra dispozita në fjalë nuk përcakton termin “duhet të” por “mund të” që nënkupton se është diskrecion i autoritetit kontraktues për të vendosur nëse ka nevojë ose jo të kërkohen sqarime shtesë në rastet e caktuara. Në rastin konkret parashtruesi ka dorëzuar licencë me afat të skaduar muaj më parë ndërsa me dosje të tenderit është kërkuar që të dorëzohet licenca e vlefshme. Pra nuk ka asgjë për të sqaruar apo për të plotësuar në këtë situatë. Pra kemi të bëjmë me një rast eklatant ku parashtruesi nuk e përmbushë kërkesën e dosjes së tenderit dhe nuk mbetet asgjë për të sqaruar më shumë lidhur me këtë fakt të pamohueshëm (të cilin nuk e konteston as vet parashtruesi si gjendje faktike).

Ngjashëm vlen edhe sa i përket pikës 10 të UPP megjithëse duhet cekur se aty nuk rregullohet fare situata e tillë. Në fakt përmes pikës 10 të UPP thuhet se në rastet kur mungon licenca e kërkuar sipas nenit 66 të LPP, mund të kërkohen sqarime shtesë.

Mungon licenca	Mund të kërkohen informata sqaruese	66
----------------	-------------------------------------	----

Megjithatë në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me licenca të kërkuara sipas nenit 66 të LPP por me një licencë të furnitorit të betonit sipas nenit 69 të LPP. Për më tepër nuk kemi të bëjmë me situatën kur mungon licenca sikurse përcaktohet me pikën 10 të UPP pasi që parashtruesi e ka dorëzuar licencën mirëpo ajo licencë është e pavlefshme me afat të skaduar (ndërsa me dosje të tenderit është kërkuar që të dorëzohet licenca e vlefshme).


Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimet parashtruesit janë tërësisht të pabazuara. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 11.12.2023

Ud.  **Visar SHEHU**  
Ndihëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

#### Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.